



kushteve të rugës ,për ta ndalur automjetin para çdo pengese të paraqitur në rrugë ,rrugë e mbuluar me borë ,dhe me të arritur në kodrën ,në një kthesë të ashpër djathtas ,nga pakujdesia e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit kalon në shiritin tjetër për qarkullim nga ana e kundërt ,me at rast me pjesën e përparme të anës së majt ,e godet në pjesën e përparme te anës së majt,automjetin tjetër të udhëtarëve të markës " "me targa të regjistrimit " "5të cilën e drejtonte i dëmtuari " "e që në momentin kritik ishte duke lëvizur nga drejtimi kundërt,me çrast nga aksidenti i shkaktuar porpos dëmeve materiale të shkaktuara në dy automjete ,lëndime të lehta trupore pësojnë pasagjeret që ishin në automjetin " " dhe Florim Hajredini që të tre nga Gjilani ,të cilët për shkak të natyrës së lëndimeve të pësuarra ,detyrohen të kërkojnë nduhmë mjekësore Spitalin Regjional në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin .1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4,41,50,51,62 dhe 73,75,dhe 76 të KPRK-së,lidhur me nenin 365 të KPPK-së të akuzuarin e gjykon ,

### **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që të pandehurit i caktohet dënimi me burgim në kohë zgjatje prej 5 muaj , të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale e në të kundërtën gjykata do të ia revokoj dënimin me kusht .

Të dëmtuarit " " nga Gjilani rr. " " p.n, " " nga Gjilani rr. " " dhe " " nga Gjilani rr. " " i p.n, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë euro)si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë e përllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate , të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i akuzuari " " obligohet të paguaj taksën në shumë prej 30 euro.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjiçan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr474/2018 të datës 11.04.2018 ndaj të pandehurit [Emri i pandehurit] nga fsh. [Emri i fshatit], Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin .1 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 15.04.2019 ka deklaruar:mbes në tërësi pran aktit akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar i akuzuari e ka pranuar fajsinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë ,për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë .Mbi bazën e këtij pranimi dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritor sipas ligjit ,i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale ,rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale .

I pandehuri [Emri i pandehurit] ka deklaruar :se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores të shtetit e kam kuptuar në tërësi ,e ndiej vehtënj fajtor dhe e pranoj fajsinë ,është hera e parë që ndeshem me ligjin ,ndiej keqardhje dhe pendohem shumë dhe se kjo dotë jetë hera e parë dhe e fundit dhe i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqyptoj një dënim sa më të butë.

Pas dëgjimit të prokurorës të shtetit dhe të akuzuarit ,gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore ,nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajsisë ,nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,pranimi mbështetet nga faktet e çështjes që përmban aktakuzën, e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë ,gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pandehuri [Emri i pandehurit],nga pakujdesija e ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin .1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e vetme gjykuese , shpalli fajtor të pandehurin [Emri i pandehurit] nga fsh. [Emri i fshatit], Komuna e Novobërdës për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastine matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73, të KPRK-së ku si rrethanë veçanarisht lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë, sjelljen korrekte në gjykatë, ka shprehur keqëardheje për kryerjen e kësaj vepre, është penduar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Nga të cekurat si më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË**

**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr.20/2018 të datës 15.04.201**

Bashkëpunëtori Profesional

Sulejman Rexhepi

*S. Rexhepi*



Gjyqtarja

Emine Salihu

*E. Salihu*

**KËSHILLA JURIDIKE** :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.